Ceno Klosi, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së

Z.Ceno Klosi është emëruar në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve sipas VKM. Nr. 625 Datë 22.10.2021.

I lindur më 12 korrik 1979, ka kryer studimet e larta dhe është diplomuar në vitin 2002, në degën Financë-Kontabilitet, pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës.

Z.Klosi ka eksperiencë të gjatë në sistemin bankar ku për më shumë se 13 vite ka mbajtur pozicione të ndryshme si Drejtor në Departamentin e Analizës së Kredisë, Drejtor në Departamentin e Riskut të Kredisë, Drejtor në Departamentin e Financimit të Strukturuar.

Gjatë periudhës 2015-2021 ka mbajtur pozicionin si Drejtor i Departamentit Ekonomik pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

Në qershor të vitit 2021 u emërua Drejtor i Përgjithshëm i Agjensisë Kombëtare Ujësjellës - Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM).

Z.Klosi ka kryer trajnime dhe është certifikuar nga institute ndërkombëtare si ekspert për asistencë në biznesin e vogël dhe kredite i mbështetur nga USAID, ka kryer programe trajnimi për kreditimin bankar organizuar nga Zhvillimi i Ndërmarrjeve në Evropën Juglindore, program trajnim për parimet e kontabilitetit me mbështjen e Qendrës së Studimeve dhe Aplikimeve Ekonomike, trajnim për analizë kredie menaxhuar nga I F C Banka Botërore.

Z.Klosi njeh dhe zotëron shumë mirë gjuhët angleze dhe italiane.